

REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
POLICUSKI INSPEKTORAT KOSOVA - POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO

Hajvali - Prishtinë



Nr./Bc. 01-02-2333/1

Data / Datum 26.12.2024

PLANI ZHVILLIMOR STRATEGJIK 2025-2027



PRISHTINË, 2024

PËRMBAJTJA

SHKURTESAT	3
PARATHËNIE	4
I. Vizioni për IPK gjatë periudhës 2025-2027	6
II. Hyrja	6
III. Analiza e përgjithshme e mjedisit	7
IV. Analiza SWOT	10
V. Plan i veprimit	11
Anex I - Tabela e Planit të Veprimit	12

SHKURTESAT

MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
PK	Policia e Kosovës
ICITAP	International Criminal Investigative Training Assistance Program
EPAC	European Partners Against Corruption
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PSO	Procedura Standarde të Operimit
KKSB	Këshilli komunal për Siguri në Bashkësi
EVSb	Ekipet vepruese për siguri në bashkësi
KLSP	Këshillat lokale për siguri publike
OJQ	Organizatat Jo-qeveritare
SHÇBA	Shërbimi për Çështje të Brendshme dhe Ankesa
FBI-LEEDA	Law Enforcement Executive Development Association
NIAIA	National Internal Affairs Investigation Association
MFPT	Ministria e Financave Punës dhe Transfereve
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KASH	Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve
ZKE	Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv
DH	Departamenti i Hetimeve
DMA	Departamenti i Menaxhimit të Ankesave
DI	Departamenti i Inspektimit
DPBÇLI	Departamenti për Planifikim, Bashkëpunim, Çështje Ligjore dhe Informim
DFSHP	Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme

PARATHËNIE

Inspektorati Policor i Kosovës, në kuptim të misionit të vet, deri sot ka arritur të evidenton rezultate të rëndësishme për rendin dhe sigurinë në Republikën e Kosovës. Si të tilla, këto rezultate janë manifestuar për shkak të punës së palodhshme dhe angazhimit profesional të secilit punonjës në IPK.

Gjatë periudhës 2022-2024 në IPK janë pranuar mesatarisht një mijë e tetëqind (1800) ankesa brenda një (1) viti. Me rëndësi të theksohet është fakti se trendi i pranimit të ankesave në IPK është trend rritës +21%. Kjo dëshmon padyshim rritjen e besimit të publikut në institucionin tonë, i cili tashmë qartazi shihet nga qytetarët si adresa e duhur për të paraqitur shqetësimet e tyre në raport me punën e policisë. Ky fakt nuk është vetëm mirënjohje për punën tonë që kemi bërë, por shërben edhe si motivim shtesë për të vazhduar misionin ligjor që kemi, tashmë si një nga institucionet më kredibile në fushën e zbatimit të ligjit.

Ne kemi një vizion të përcaktuar saktë, i cili konsiston në rritjen e kapaciteteve tona për të rritur edhe më shumë efikasitetin dhe efektivitetin e punës tonë, në funksion të misionit ligjor që kemi. Prandaj qëllimi i Planit Zhvillimor Strategjik 2025-2027 është pikërisht identifikimi i qëllimeve, objektivave dhe aktiviteteve strategjike për të realizuar këtë vizion brenda periudhës përkatëse.

Ky dokument strategjik është ndërtuar mbi bazën e analizës së përgjithshme të mjedisit në Inspektoratin Policor të Kosovës e cila ka pasqyruar gjendjen aktuale brenda institucionit. Duke u referuar te kjo analizë, është arritur të shkoqiten disa anë të forta dhe disa dobësi eventuale. Njëkohësisht janë shpërfaqur edhe mundësitë që ekzistojnë për të tejkaluar këto dobësi duke ju falënderuar edhe anëve të forta të identifikuar paraprakisht. Kuptohet se janë evidentuar edhe rreziqet e mundshme të cilat mund të kanosen në rast se nuk shfrytëzohen këto mundësi dhe nuk eliminohen dobësitë përkatëse. Në këtë mënyrë është kompletuar analiza e përgjithshme duke përdorur teknikën SWOT (Strengths, Weaknesses, Opportunities, Threats).

Plani i Veprimit të këtij dokumenti strategjik, nënkupton listën e qëllimeve, objektivave dhe aktiviteteve konkrete strategjike të cilat duhet të përmbushen brenda afatit të përcaktuar. Natyrisht se për secilin aktivitetet është identifikuar departamenti, respektivisht divizioni përgjegjës si dhe autoriteti mbështetës gjatë përmbushjes.

Po ashtu është përlogaritur edhe kosto e secilit aktivitet veç e veç, si dhe është përcaktuar parametri matës përmes të cilit do të raportohet mbi përgjegjësinë lidhur me përmbushjen e aktiviteteve nga të gjitha autoritetet përgjegjëse. Kjo për arsye se IPK do të hartojë Planet Vjetore të Punës për secilin departament, pikërisht duke u bazuar në objektivat dhe aktivitetet strategjike të paracaktuara me Planin Zhvillimor Strategjik 2025-2027. Në këtë mënyrë, do të krijohen mundësitë për të bërë edhe vlerësimin vjetor lidhur me progresin e implementimit të këtij dokumenti strategjik gjatë periudhës për të cilën është i vlefshëm (2025-2027).

Duhet cekur se procesi i hartimit dhe miratimit të Planit Zhvillimor Strategjik 2025-2027 së bashku me Planin e Veprimit, ka qenë proces mjaft kompleks dhe mjaft i gjatë i cili ka kërkuar përfshirjen e punonjësve të ndryshëm nga të gjitha departamentet në IPK. Prandaj në cilësinë e Kryeshefit Ekzekutiv në IPK dëshiroj të falënderoj të gjithë punonjësit nga IPK dhe nga MPB të cilët kanë qenë të përfshirë në hartimin e këtij dokumenti. Padyshim se IPK është falënderuese edhe ndaj partnerëve ndërkombëtar ICITAP dhe OSBE të cilët e kanë mbështetur këtë proces që nga fillimi deri në fund. Duhet shtuar që procesi i hartimit të këtij dokumenti ka qenë i mbikëqyrur dhe përkrahur edhe nga Ministria e Punëve të Brendshme. Në këtë mënyrë është konfirmuar se ky dokument është në harmoni jo vetëm me Planin Kombëtar Zhvillimor të Republikës së Kosovës 2025-2027, por edhe me Planin e Punës së Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Me respekt,



Kushtrim Hodaj
Kryeshef Ekzekutiv
Inspektorati Policor i Kosovës

VIZIONI PËR IPK NË PERIUDHËN 2025-2027

IPK synon të fuqizoj rolin dhe kompetencat ligjore duke mbrojtur integritetin institucional dhe ngritur nivelin e profesionalizmit në funksion të misionit ligjor.

HYRJA

Plani Zhvillimor Strategjik 2025-2027 ka për qëllim të përcaktoj orientimin strategjik të Inspektoratit Policor të Kosovës për tri (3) vitet vijuese (2025-2027). Ky dokument është në përputhje Planin Kombëtar për Zhvillimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 2025-2027, Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH 2025-2027), si dhe kornizën juridike në fuqi që është e zbatueshme për Inspektoratin Policor të Kosovës. Rrjedhimisht, Plani Zhvillimor Strategjik 2025-2027 është në funksion të zbatimit sa më eficient të misionit të IPK-së, i cili konsiston në sigurimin e shërbimeve policore transparente, të përgjegjshme dhe demokratike sipas standardeve ndërkombëtare.

Plani Zhvillimor Strategjik synon të përcaktoj bazën për miratimin e Planeve Vjetore të Punës për të gjitha departamentet në IPK gjatë periudhës së vlefshmërisë së këtij dokumenti (2025-2027). Në këtë mënyrë ky dokument strategjik bazohet në analizën e përgjithshme të mjedisit në IPK, prej të cilës derivon edhe analiza SWOT, përkatësisht analiza lidhur me anët e forta, anët e dobëta, mundësitë si dhe rreziqet me të cilat mund të ballafaqohet Inspektorati Policor i Kosovës gjatë periudhës kur do të jetë në fuqi ky Plan Zhvillimor Strategjik.

Duke marrë parasysh të thënat më sipër, ky dokument strategjik manifestohet përmes tri (3) qëllimeve strategjike të cilat reflektohen përmes dymbëdhjetë (12) objektivave strategjike dhe të cilat më tutje konkretizohen përmes pesëdhjetë e shtatë (57) aktiviteteve konkrete. Natyrisht se për secilin aktivitet është përcaktuar afati kohor brenda të cilit kërkohet përmbushja, parametri matës si dhe kosto financiare për përmbushjen e aktivitetit përkatës.

Vlen të theksohet se aktivitetet strategjike të përcaktuara përmes këtij Plani Zhvillimor Strategjik, nuk janë ekskluzivisht përshkrim i detyrave dhe përgjegjësiwe ligjore që ka Inspektorati Policor i Kosovës. Në këtë mënyrë qëllimet, objektivat si dhe aktivitetet strategjike në këtë dokument duhet të interpretohen në funksion të rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit me rastin e përmbushjes së kompetencave ligjore të IPK-së.

I. ANALIZA E PËRGJITHSHME E MJEDISIT

Inspektorati Policor i Kosovës është institucion ekzekutiv i pavarur nga Policia e Kosovës, mirëpo në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. IPK është themeluar në vitin 2006 dhe ka për mision që, përmes ushtrimit të veprimtarisë së tij, të siguroj shërbime policore demokratike, të përgjegjshme dhe transparente, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e përcaktuara.

Me rastin e zbatimit të detyrave dhe përgjegjësiwe ligjore, parimet themelore me të cilat shërbehet IPK janë: ligjshmëria, transparenca, llogaridhënia, paanshmëria, profesionalizmi, integriteti dhe mos diskriminimi.


Në përputhje me Ligjin nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës, objekti i veprimtarisë së IPK është si në vijim:

1. parandalimi, zbulimi dhe hetimi i veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Kosovës pa dallim grade dhe pozite gjatë detyrës zyrtare ose jashtë saj;
2. parandalimi, zbulimi dhe hetimi i veprave penale të kryera nga personat e dyshuar që nuk janë punonjës në Policinë e Kosovës, mirëpo dyshohet se janë të përfshirë në kryerjen e veprave penale së bashku me punonjës të Policisë së Kosovës;
3. inspektimi i strukturave dhe funksioneve të Policisë së Kosovës për të siguruar llogaridhënie, efektivitet dhe efikasitet në zbatueshmërinë e ligjeve, akteve nënligjore dhe procedurave standarde të operimit në fuqi;
4. hetimi dhe/ose inspektimi i incidenteve disiplinore të profilit të lartë, ku përfshihen të gjithë punonjësit e Policisë së Kosovës;
5. hetimi i shkeljeve disiplinore të supozuara të zyrtarëve policor me gradën më të lartë të nivelit të lartë të menaxhimit dhe zyrtarëve policor të nivelit të lartë ekzekutiv;
6. hetimi i Drejtorit të Përgjithshëm në Policinë e Kosovës për shkelje disiplinore apo vepër penale në përputhje me ligjin për Inspektoratin Policor të Kosovës;
7. pranimi dhe shqyrtimi i të gjitha ankesave që pranohen në IPK.

Duhet theksuar se për të mbuluar strukturën organizative të Inspektoratit Policor të Kosovës dhe bazuar në Rregulloren (MPB) NR. 01/2017 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në IPK, numri i personelit për Inspektoratin Policor të Kosovës është nëntëdhjetë e nëntë (99), ndërsa bazuar në ligjin nr. 08/1-332 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, numri i punonjësve të aprovuar është njëqind e shtatë (107). Megjithatë në IPK aktualisht janë të punësuar vetëm tetëdhjetë e katër (84) punonjës. Kjo nënkupton se duhet të rekrutohen edhe njëzetë e tre (23) punonjës të tjerë. Duhet shtuar se në mesin e këtyre tetëdhjetë e katër (84) punonjësve që aktualisht janë në IPK, gjashtëdhjetë e katër (64) prej tyre janë

punonjës operativë (hetues dhe inspektor) ndërsa njëzet (20) janë punonjës personel mbështetës (personeli administrativ).

Fig. 1. Struktura organizative në Inspektoratin Policor të Kosovës



Në figurën më sipër është pasqyruar struktura organizative në IPK e cila përbëhet nga Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv dhe pesë (5) departamente, të cilat përfshijnë gjithsej shtatëmbëdhjetë (17) divizione. Departamentet nga të cilat përbëhet IPK janë:

- I. Departamenti i Hetimeve;
- II. Departamenti i Menaxhimit të Ankesave;
- III. Departamenti i Inspektimit;
- IV. Departamenti për Planifikim, Bashkëpunim, Çështje Ligjore dhe Informim;

V. Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme

Bazuar në të dhënat e tre (3) viteve të fundit (2022-2024), Departamenti i Menaxhimit të Ankesave ka pranuar dhe shqyrtuar brenda një (1) viti mesatarisht një mijë e tetëqind (1800) ankesa. Numri më i madh i tyre janë ankesa të drejtpërdrejta nga qytetarët në Inspektoratin Policor të Kosovës. Si rezultat i trajtimit të këtyre ankesave, Departamenti i Menaxhimit të Ankesave brenda një (1) viti ka proceduar për hetim penal mesatarisht (600) ankesa ndërsa rreth një mijë e dyqind (1200) raste janë dërguar në Policinë e Kosovës për hetim eventual disiplinor. Trendi i pranimit të ankesave në IPK gjatë periudhës 2022-2024 është trend rritës (+21%).

Departamenti i Hetimeve në IPK, për periudhën në fjalë ka trajtuar mesatarisht rreth treqind e shtatëdhjetë (370) raste brenda një (1) viti. Prej tyre, mesatarisht tetëdhjetë (80) raste në vit kanë përfunduar me kallëzim penal, rreth dyzet e dy (42) raste të tjera kanë përfunduar me raport të veçantë, njëqind e pesëdhjetë e pesë (155) raste janë dorëzuar me raport informues.

Duhet shtuar po ashtu se gjatë periudhës në fjalë (2022-2024), mesatarja e numrit të rasteve që janë bartur në vitin pasues është mesatarisht rreth dyqind e dyzet (240) raste. Përndryshe, veprat penale që ka hetuar më shpesh Departamenti i Hetimeve gjatë kësaj periudhe janë "keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike" (neni 195 në KPK)," keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar (neni 414 në KPK), lëndim i lehtë trupor (neni 185 në KPK)," kanosja" (neni 181 në KPK) si dhe "sulmi" (neni 184 në KPK).

Sa i përket hetimit të shkeljeve disiplinore, Departamenti i Hetimeve në IPK gjatë viteve 2022-2024, mesatarisht brenda një (1) viti ka hetuar shtatëmbëdhjetë (17) raste të dyshuara disiplinore në përputhje me kompetencat ligjore.

Sa i përket Departamentit të Inspektimeve, duhet cekur se gjatë periudhës 2022-2024 ky departament ka zhvilluar brenda një (1) viti mesatarisht pesëmbëdhjetë (15) inspektime të rregullta dhe të jashtëzakonshme.

Për fund, duhet theksuar se ky Plan Zhvillimor Strategjik (2025-2027) ka reflektuar gjithashtu mbi të gjeturat e raportit lidhur me zbatimin e Planit Zhvillimor Strategjik paraprak (2022-2024). Rrjedhimisht, nga dokumenti paraardhës janë bartur disa objektiva dhe aktivitete strategjike siç është mungesa e numrit të mjaftueshëm të zyrave rajonale si dhe numri i pamjaftueshëm i burimeve njerëzore.

III. ANALIZA SWOT



IV. PLANI I VEPRIMIT

Plani i veprimit të Planit Zhvillimor Strategjik 2025-2027 përbëhet nga tri (3) qëllime strategjike si në vijim:

- I. Fuqizimi i rolit dhe kapaciteteve të Inspektoratit Policor të Kosovës që të sigurohet një polici e përgjegjshme, demokratike dhe transparente;**
- II. Ushtrimi proaktiv i kompetencave ligjore të Inspektoratit Policor të Kosovës për të ngritur nivelin e integritetit në Policinë e Kosovës;**
- III. Fuqizimi dhe promovimi i partneritetit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare.**

Secili qëllim strategjik manifestohet përmes objektivave përkatëse strategjike të cilat konkretizohen më tutje përmes aktiviteteve konkrete. Natyrisht se për secilin aktivitet strategjik është përcaktuar departamenti apo divizioni përgjegjës si dhe autoritetet tjera mbështetëse me rastin e përmbushjes së aktivitetit përkatës. Në kuadër të planit të veprimit janë të përcaktuar po ashtu afatet kohore brenda të cilave duhet të përmbushet secili aktivitet, pastaj kostot e tyre financiare si dhe parametri matës specifik. Duhet shtuar se kostot financiare të përcaktuara në shifra në kuadër të planit të veprimit nuk janë kosto definitive por janë vetëm parashikime të përafërta të cilat do të specifikohen në baza vjetore me rastin e planifikimit buxhetor.

Inspektorati Policor i Kosovës do të ndërmerr të gjitha masat dhe veprimet e mundshme për të përmbushur në tërësi secilin aktivitet të përcaktuar me planin e veprimit të këtij dokumenti strategjik. Megjithatë, duhet të theksohet se përmbushja e shumë prej aktiviteteve strategjike varen edhe nga institucionet tjera ku përfshihen, por nuk kufizohen me MPB, MFPT, PK, KPK, KGJK etj. Nga ky këndvështrim, IPK-ja do të vazhdoj që të fuqizoj bashkëpunimin e saj me të gjitha institucionet përkatëse vendore dhe ndërkombëtare me qëllim të përmbushjes së vizionit të saj dhe aktiviteteve të përcaktuara me këtë dokument.

Vlen të theksohet se Plani Zhvillimor Strategjik 2025-2027, është dokument dinamik. Prandaj IPK do të bëj vlerësimin vjetor të zbatimit të këtij dokumenti me qëllim të identifikimit të sfidave apo ngecjeve eventuale gjatë zbatimit. Në këtë mënyrë synohet të evidentohet nevoja për rishikim eventual të Planit Zhvillimor Strategjik 2025-2027 dhe Planit të Veprimit. Njëkohësisht synohet edhe të evidentohen mundësitë për të adresuar në mënyrën e duhur ngecjet dhe sfidat eventuale që mund të identifikohen.

ANEX I – Tabela e Planit të Veprimit

Qëllimi strategjik	Objektivi strategjik	Aktiviteti	Departamenti/ Divizioni përgjegjës	Institucioni/Departamenti/Divizioni mbështetës	Afati kohor	Kosto / €	Parametri matës
1.Fuqizimi i rolit dhe kapaciteteve të Inspektoratit Policor të Kosovës që të sigurohet një polici e përgjegjshme, demokratike dhe transparente.	1.1 Ngritja e profesionalizmit të punonjësve dhe fuqizimi i kapaciteteve të IPK-së.	Hartimi dhe miratimi i analizës për nevojat e trajnimeve.	DPBÇLI/ZKE	DBNJ/ të gjitha departamentet	T1 2025	Kosto administrati ve	Analiza e nevojave për trajnime
		Hartimi dhe miratimi i strategjisë së trajnimeve.	DPBÇLI/ZKE	DBNJ/ të gjitha departamentet	Miratimi Strategjisë T2-T3 2025 Zbatimi 2025/2027	Donacion nga OSBE/ Kosto Administrati ve	Dokumenti-Strategjia e trajnimeve
		Plotësimi i vendeve të lira sipas strukturës organizative.	ZKE	DFSHP/të gjitha departamentet	T2- T3 2025	E buxhetuar	Plotësimi i strukturës
		Hartimi dhe azhurnimi vjetor i listës së rreziqeve.	ZKE/DPBÇLI	Të gjitha departamentet	2025-2027 (T3)	Kosto administrati ve	Lista e rreziqeve
		Kryeshefi dhe menaxhmenti të mbajnë takime vjetore me punonjësit e IPK për të arriturat dhe sfidat e institucionit.	ZKE	Të gjitha departamentet	TM 4 2025-2027	Kosto administrati ve	Takimi vjetor
	1.2 Ofrimi i shërbimeve sa	Hapja e zyrave të reja rajonale	ZKE/DFSHP	Të gjitha departamentet dhe MPB	2025-2027	Kosto administrati ve	Zyrat rajonale të reja

<i>më afër qytetarëve.</i>	<i>Funksionimi i “Linjës së kaltër”</i>	<i>ZKE/DMA</i>	<i>DMA/DH/DI/DPBÇLI</i>	<i>2025-2027 vazhdimës i</i>	<i>Kosto administrati ve</i>	<i>Mirëmbajtja e radio-logut /numri i Thirrjeve</i>
1.3 Sigurimi i kushteve, pajisjeve dhe shërbimeve efikase mbështetëse për funksionet e IPK-së.	<i>Rritja e kapaciteteve të flotës së automjeteve në IPK.</i>	<i>DFSHP</i>	<i>MPB/MF dhe AQP</i>	<i>TM1 2025 TM 32026</i>	<i>352.188 €</i>	<i>14 Automjete</i>
	<i>II. Krijimi i sistemit elektronik të menaxhimit të rasteve.</i>	<i>DFSHP</i>	<i>Të gjitha departamentet</i>	<i>TM2 - TM3 2025-2027</i>	<i>Donacion 300 000,00€ Pjesërisht e buxhetuar</i>	<i>Data baza</i>
	<i>III. Digjitalizimi i sistemit për administrimin e linjës së kaltër dhe flotës së automjeteve.</i>	<i>DFSHP</i>	<i>ZKE/të gjitha departamentet</i>	<i>TM3- TM 4 2025- 2027</i>	<i>60.000</i>	<i>Sistemi i digjitalizuar</i>
	<i>Krijimi i aplikacionit për telefonat mobil lidhur me raportim të rasteve.</i>	<i>DFSHP</i>	<i>DMA</i>	<i>2026</i>	<i>Donacion i buxhetuar</i>	<i>Aplikacioni i krijuar</i>
	<i>IV. Plotësimi i nevojave për pajisje për masa të fshehta dhe pajisjet përcjellëse.</i>	<i>DH</i>	<i>DFSHP</i>	<i>TM2- TM3 2025-2027</i>	<i>120 000,00€ /donacion</i>	<i>Pajisjet</i>

		V. Furnizimi me pajisje për ruajtjen e armëve.	DH	DFSHP	2025 TM2	3.500€	Pajisjet
		VI. Furnizimi me pajisje të teknologjisë informative të nevojshme për punonjësit e IPK-së.	DFSHP	Të gjitha departamentet /AQP	2025-2027 vazhdimësi	45 000,00€	Pajisjet e TI
		VII .Pajisje për përkthim, zërim dhe komunikim.	DFSHP	Të gjitha departamentet	vazhdimësi	21, 000,00 donacion	Pajisjet
		X. Ngritja e nivelit të sigurisë kibernetike në IPK.	DFSHP	DTISHL/MPB	2025-2027 vazhdimësi	Kosto administrati ve	Azhurnimi i infrastrukturës së TIK
		XI .Mirëmbajtja e sistemit të kamerave vëzhguese CCTV-në objektin qendror të IPK-së.	DFSHP	DTISHL/MPB	2025-2027 vazhdimësi	13,928.86	Kontratata e OE
		XII. Zgjerimi i hapësirave të punës.	MPB	DFSHP	2025	E buxhetuar	Renovimi i aneks objektit
		XIII. Krijimi i bazës së të dhënave të DBNJ për trajnime.	DBNJ-DTISHL	DFSHP	TM 3 2025	E pabuxhetuar /donacion	Data baza

		XIV. Ngritja e kapaciteteve teknike të IPK-së për këqyrjen e vendit të ngjarjes dhe mbledhjen e dëshmive.	ZKE	DH	2025-2027 Vazhdimësi	E buxhetuar /donacion	Ngritja e kapaciteteve teknike
		XV. Kontrollët periodike mjekësore për punonjësit e IPK-së.	DFSHP	ZKE/ Të gjitha departamentet	2025-2027	E buxhetuar 15.000	Kontrollët periodike
1.4Plotësim/ndryshimi i ligjit dhe akteve nënligjore të IPK-së.		Pjesëmarrja në grupin punues për ndryshim/plotësimin e ligjit për IPK-në.	MPB/ZKE	Të gjitha departamentet/MPB dhe partneret	2025-2027	Kosto administrati ve	Pjesëmarrja në grupin punues
		Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore bazuar në ligjin për IPK dhe ligjet e reformës së administratës publike.	ZKE/DPÇL	Të gjitha departamentet/MPB	TM 1 2025	Kosto Administrati ve	Aktet nënligjore
		Hartimi i analizës dhe propozimeve lidhur me nevojat e IPK për hartimin apo ndryshim/plotësimin e akteve nënligjore lidhur me çështjet që IPK	ZKE/MPB	Të gjitha departamentet	2025-2027 vazhdimësi	Kosto administrati ve	Hartimi i analizave me propozime

		<i>i konsideron të nevojshme.</i>					
1.5 Të sigurohet transparencë e vazhdueshme lidhur me fushëveprimin ligjor të IPK-së.	I. Të ofrohet qasje e shpejtë dhe efikase në informatat me interes për publikun.	ZKE/DBI	Të gjitha departamentet	2025-2027 vazhdimës i	Kosto administrati ve	Numri i informatave	
	II. Azhurnim në vazhdimësi i ueb faqes zyrtare, rritja e numrit të publikimeve në ueb faqe të IPK-së dhe ndërlidhja me platformën E-Kosova.	DTISHL/DBI	Të gjitha departamentet	2025-2027 vazhdimës i	Kosto administrati ve	Azhurnimi Publikimet	
	IV. Publikimi i revistës “Integriteti” dhe buletinit elektronik “Linja e kaltër”.	DBI	Të gjitha departamentet	2025-2027 TM4 – Revista Buletini – vazhdimës i	7 000,00€	Publikimi i revistës dhe buletinit	
	V. Publikimi i raporteve të inspektimit përmes komunikatave për media dhe	DI	DTISHL/DBI	2025-2027 vazhdimës i	Kosto administrati ve	Numri i raporteve dhe komunikatave për media	

		<i>organizimi i konferencave për shtyp.</i>					
		<i>VI. Aktivitete në fushën e marrëdhënieve me publikun.</i>	<i>DBI</i>	<i>Të gjitha departamentet</i>	<i>2025-2027 vazhdimës i</i>	<i>Kosto administrati ve</i>	<i>Numri i aktiviteteve</i>
		<i>VII. Mirëmbajtja dhe ngritja e nivelit të komunikimit me qytetarë përmes rrjeteve sociale.</i>	<i>DBI</i>	<i>Të gjitha departamentet</i>	<i>2025-2027 vazhdimës i</i>	<i>Kosto administrati ve</i>	<i>Mirëmbajtja e rrjeteve sociale dhe rritja e numrit të ndjekësve</i>
		<i>VIII. Njoftimi i ankuesve për statusin e ankesave që trajtohen në IPK.</i>	<i>DH/DMA</i>	<i>DFSHP</i>	<i>2025-2027 vazhdimës i</i>	<i>e buxhetuar</i>	<i>Numri i njoftimeve për ankuesit/të dëmtuarit</i>
	<i>1.6 Të përgatitet dhe implementohet plani i integritetit për IPK-në.</i>	<i>Implementimi dhe përditësimi i Planit të Integritetit.</i>	<i>ZKE/DPBÇLI</i>	<i>Të gjitha departamentet</i>	<i>vazhdimës i</i> <i>TM 3 2027</i>	<i>Kosto administrati ve</i>	<i>Plani i integritetit i përditësuar</i>
<i>II. Ushtrimi proaktiv i kompetenc</i>	<i>2.1 Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit në parandalimin</i>	<i>Rritja e numrit të hetimeve preliminare nga DMA</i>	<i>DMA</i>	<i>DH</i>	<i>2025-2027 vazhdimës i</i>	<i>Kosto administrati ve</i>	<i>Numri i hetimeve preliminare</i>

ave ligjore të Inspektoratit Policor të Kosovës për të ngritur nivelin e integritetit në Policinë e Kosovës.	dhe hetimin e veprave penale dhe shkeljeve disiplinore sipas kompetencave ligjore të IPK-së.	II. Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit të pranimet dhe trajtimit të rasteve kur është e nevojshme dalja në vendin e ngjarjes apo në rastet kur kërkohen veprime urgjente.	DH	Të gjitha departamentet	2025-2027 vazhdimës i	Kosto administrati ve	Numri i rasteve me dalje në vendin e ngjarjes dhe rasteve ku kërkohen veprime urgjente
		III. Përcjellja e burimeve të hapura dhe adresimi i shkeljeve të dyshuara nga PK, sipas detyrës zyrtare.	DBI/DH	Të gjitha departamentet	2025-2027 vazhdimës i	Kosto administrati ve	Numri i rasteve të iniciuara sipas detyrës zyrtare
		Prioritizimi i hetimit për veprat penale bazuar në ndjeshmërinë dhe ndërlikueshmërinë e tyre.	DH	Të gjitha departamentet tjera	2025-2027 vazhdimës i	Kosto administrati ve	Numri i rasteve të prioritizuara
		Identifikimi dhe trajtimi i rasteve për shkak të incidenteve disiplinore të profilit të lartë	DH/DI	DMA	2025-2027 vazhdimës i	Kosto administrati ve	Numri i rasteve të trajtuara për shkak të incidenteve disiplinore të profilit të lartë

		<i>Shenjëzimi i rasteve të dyshuara të korrupsionit.</i>	<i>DH</i>	<i>ZKE/Prokuroria e shtetit</i>	<i>2025-2027 vazhdimës i</i>	<i>Kosto administrati ve</i>	<i>Numri i rasteve të shenjëzuara</i>
		<i>VII. Menaxhimi i kohës te hetimit penal paraprak sipas planeve të hetimit</i>	<i>DH</i>	<i>Të gjitha departamentet</i>	<i>2025-2027</i>	<i>Kosto administrati ve</i>	<i>Numri i planeve të veprimeve hetimore</i>
		<i>VIII. Zvogëlimi i përqindjes së numrit të rasteve në DH që barten në vitin vijues.</i>	<i>DH</i>	<i>DMA/të gjitha departamentet</i>	<i>2025-2027</i>	<i>Kosto administrati ve</i>	<i>Përqindja e rasteve të përfunduara në DH</i>
	<i>2.2 Mbikëqyrja e vazhdueshme e punës policore përmes realizimit të inspektimeve</i>	<i>I. Inspektime të zgjeruara të funksioneve dhe performancës së strukturave policore (të rregullta dhe të jashtëzakonshme.</i>	<i>DI</i>	<i>ZKE/MPB/PK/të gjitha departamentet</i>	<i>2025-2027 vazhdimës i</i>	<i>Kosto administrati ve</i>	<i>9 Raporte</i>
		<i>Inspektime të ngushta të funksioneve dhe performancës së strukturave policore të rregullta dhe të jashtëzakonshme.</i>					<i>21 Raporte</i>
		<i>III. Inspektime të shpejta mbi dyshimet për parregullsi të caktuara të</i>	<i>DI/</i>	<i>ZKE/MPB/të gjitha departamentet</i>	<i>2025-2027</i>	<i>Kosto administrati ve</i>	<i>21</i>

		<i>niveleve të ndryshme të organizimit policor.</i>					
		<i>IV. Inspektime mbi respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, si rezultat i incidenteve që zgjojnë vëmendjen e publikut, kërkesave dhe raporteve vendore dhe ndërkombëtare, ku përfshihen dhuna në familje, dhuna në baza gjinore, krimet e urrejtjes etj.</i>	<i>DI/DH</i>	<i>ZKE/MPB/ të gjitha departamentet</i>	<i>2025-2027</i>	<i>Kosto administrati ve</i>	<i>Sipas nevojës</i>
	<i>2.3 Ngritja e cilësisë së inspektimit dhe raportimit.</i>	<i>I. Rishikimi i formateve të raporteve të inspektimit - raporti i inspektimeve të shpejta.</i>	<i>DI</i>	<i>ZKE</i>	<i>TM 1 2025</i>	<i>Kosto administrati ve</i>	<i>Forma e raportit të inspektimit të shpejtë</i>
		<i>III. Vizualizimi i rezultateve të inspektimit përmes platformës elektronike të</i>	<i>DI/DTI</i>	<i>ZKE/</i>	<i>2026</i>	<i>Kosto administrati ve</i>	<i>Krijimi i linkut</i>

		<i>qasshme për publikun.</i>					
		<i>IV. Aplikimi i metodës randomizer për përzgjedhjen e mostrave të kontrollit të dosjeve</i>	<i>DI</i>		<i>vazhdimës i</i>	<i>Kosto Administrati ve</i>	<i>Metoda Randomizer</i>
	<i>2.4 Rritja e numrit të aktiviteteve për edukim dhe promovim të integritetit të Policisë së Kosovës.</i>	<i>I. Realizimi i prezantimeve/punëtorive/takimeve para kadetëve policor AKSP lidhur me fushë veprimtarinë e IPK-së, integritetin policor, trajnimin e vijës së parë dhe të dytë të menaxhimit në PK.</i>	<i>DPBÇLI</i>	<i>ZKE/ AKSP/PK</i>	<i>2025-2027 vazhdimës i</i>	<i>Kosto administrati ve</i>	<i>Numri i aktiviteteve</i>
<i>Fuqizimi dhe promovimi i partneritetit me institucionet vendore</i>	<i>3.1 Fuqizimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitutional.</i>	<i>I. Strukturimi dhe fuqizimi i bashkëpunimit ndërinstitutional.</i>	<i>ZKE/DPBÇLI</i>	<i>MPB/të gjitha departamentet</i>	<i>2025-2027 vazhdimës i</i>	<i>Kosto administrati ve</i>	<i>Caktimi i personave përgjegjës dhe përcaktimi i formave të bashkëpunimit ndërinstitutional</i>

dhe ndërkombëtare.		III. Vazhdimi i implementimit të memorandumeve në fuqi dhe nënshkrimi i memorandumeve të reja me agjencitë e tjera të linjës sipas nevojës.	ZKE	MPB	2025-2027 vazhdimës i	Kosto administrati ve	Numri i memorandumeve të nënshkruara dhe numri i aktiviteteve për memorandumi n ekzistues
		IV. Themelimi i ekipeve të përbashkëta dhe zhvillimi i operacioneve të përbashkëta me akterët vendor.	ZKE	Te gjitha Departamentit/PK/MPB/ Prokuroria	2025-2027 vazhdimës i	Kosto administrati ve	Numri i ekipeve/hetimeve të përbashkëta
		V. Pjesëmarrja e menaxhmentit të IPK në takime me menaxhmentin rajonal të Policisë dhe forumeve të sigurisë.	ZKE/DPBÇLI	DH,DI, DMA	2025-2027 vazhdimës i	Kosto administrati ve	9 Takime
	3.2 Bashkëpunimi dhe koordinimi ndërkombëtar i IPK-së.	I. Angazhimi i mëtejshëm për anëtarësim në organizata ndërkombëtare në fushën e mbikëqyrjes policore dhe në fushën e sigurisë.	ZKE/DPBÇLI	MPB/Partnerët	2025-2027 vazhdimës i	Kosto administrati ve	Numri i aktiviteteve me qëllim të anëtarësimit

		<i>II. Vazhdimi i implementimit të marrëveshjes së bashkëpunimit në fuqi si dhe angazhimi për lidhjen e marrëveshjeve të reja me shtetet e rajonit.</i>	<i>DI/DH</i>	<i>Të gjitha departamentet/MPB</i>	<i>2025-2027</i>	<i>Kosto administrati ve</i>	<i>Numri i aktiviteteve të përbashkëta dhe numri i angazhimeve për marrëveshje të reja</i>
		<i>III. Themelimi i ekipeve të përbashkëta të hetimit/inspektimit me vendet e rajonit mbi bazën e marrëveshjeve të nënshkruara apo të parimit të reciprocitetit.</i>	<i>DI/DH</i>	<i>MPB</i>	<i>2025-2027 vazhdimës i</i>	<i>Kosto administrati ve</i>	<i>Numri i ekipeve të përbashkëta</i>
		<i>Angazhim me qëllim të funksionalizimit të plotë të forumit rajonal të agjencive mbikëqyrëse të sigurisë.</i>	<i>ZKE/DPBÇLI</i>	<i>Të gjitha departamentet/Partnerët</i>	<i>2025</i>	<i>Kosto administrati ve</i>	<i>Funksionalizimi i plotë i forumit rajonal.</i>
		<i>IV. Pjesëmarrja në konferencat e EPAC, NIAIA si dhe në organizime tjera ndërkombëtare.</i>	<i>ZKE/DPBÇLI</i>	<i>Të gjitha departamentet</i>	<i>2025-2027 vazhdimës i</i>	<i>Kosto administrati ve /donacion</i>	<i>Pjesëmarrja dhe aktivitetet në kuadër të konferencës</i>